



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 28.01.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.01.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Besa Security" për aktivitetin: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Besa Security" e datës 27.01.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër *Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 20.01.2020, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet Njoftimi i Autoritetit Kontraktues** i publikuar me datë: 20.01.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj respektimin e Vendimit të datës 20.01.2020*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Besa Security" me datë 27.01.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 28.01.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet që kanë të bëjnë me pagën bruto janë të pa bazuara pasi që këto janë sqaruar në raportin e rivlerësimit, i cili është kryer në përputhje me rekomandimet e Vendimit të OSHP-së dhe interpretimit të ATK-së që është kërkuar me rekomandim të të njëjtit Vendim dhe si të tilla janë të pa bazuara;

-Poashtu pretendimi se ju për kohën e pushimeve vjetore i zëvendësoni me puentoret me page me të ulet është plotësisht i pa bazuar, pasi që këtu kemi të bëjmë me pagën e rregullte që i

paguhet punetorit me pagen 250.00 euro e jo me pagen e zevendesuesit,e cila nese kalkulohet ne çfardo shume vetem e shton detyrimin tuaj financiar;

-Pretendimi lidhur me pagesen e punes per vikend poashtu eshte i pa bazuar,pasi qe ne rivleresim autoriteti kontraktues sipas rekomandimeve te OSHP-se dhe ekspertizes e ka trajtura si kriter jo te matshem dhe nuk e ka perfshire ne kalkulimin e çmimit;

-Pretendimet lidhur me vazhdimin e validitetit te tenderit jane te pa bazuara,pasi qe Autoriteti Kontraktues me kohe ka kerkuar vazhdimin e validitetit dhe sigurimit te tenderit dhe ju si pjesemarrës e keni sjellur sigurimin e dates 10/11/2019,qe nenkupton se ky pretendim i juaji eshte ose tendencioz ose nuk jeni te njoftuar me veprimet tuaja te meparme,e qe d.t.th.se nuk kemi te bejme me asnje shkelje nga AK-ja.Lidhur me kete bashke me kete Vendim do te keni bashkengjitur edhe kopjet e sigurimit te dorezuar nga ju;

-Pretendimi se duhet te veprojme njesoj me vleresimet si ne procedurat emergjente te negociuara poashtu eshte i pa bazuar,pasi qe ne te njejtat eshte kerkuar vetem çmimi me i ulet dhe deklarimet e tenderueseve pasi qe procedura emergjente nuk na lejon komoditet qe te merremi me gjithfare pretendimesh e te mos kemi kontrate per kryerjen e sherbimeve.Ne rastin e kesaj procedure te hapur çdo veprim ne rivleresim eshte bere ne harmoni me rekomandimet e Vendimit te OSHP-se dhe interpretimit te ATK-se;

-Pretendimi per " perputhmerine" e vleres se parashikuar me sqarimet e AK-se per plus/minus 30% me çmimin total te tenderuesit te OE-ik te rekomanduar per kontrate,sigurisht se eshte rastesi qe ka mund ti ndodh secilit pjesemarrës,pasiqe ato sqarime u jane derguar te gjithë te interesuareve per pjesemarrje nepermes E prokurimit.Por duhet t'iu sqarojme se bazuar ne Vendimin e OSHP-se Autoriteti Kontraktues ka bere kalkulimin e çmimit vetem per ore pune dhe sipas te njejtat eshte bere rekomandimi per dhenje te kontrates,ndersa vlerat ne Njoftimin per Vendimin e AK-se jane paraqitur si qe jane dhene ne ofertat e dorezuara nga tenderuesit;dhe

-Pretendimi per te paraqitur kalkulimin real te çmimit ne tabelen qe keni dorezuar eshte ne kundërshtim me rekomandimet e Vendimit te OSHP-se dhe interpretimit te ATK-se,sipas te cileve eshte paraqitur kalkulimi ne Raportin e rivleresimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet e dhena ne Raportin e rivleresimit vendosi si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Deklarat e Garancionit

Nr Policës
Pririv Nr: 1008757

Sigurimi i Tenderit

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES
(Autoriteti kontraktues)

Në emër të: KS"BESA SECURITY"SHPK
(Operatori ekonomik)

Titulli i aktivitetit: Sigurimi i objekteve te Komunes se Prishtines

Nr i Prokurimit: 616-19-3238-211

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri e garancionit duke iu referuar dosjes, me numër të prokurimit/dosjes të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurimin e garancionit në shumën e saktësuar të specifikuar në dosje;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë sigurim:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total e shuma e sigurimit, zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos pëmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- 1 Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivist, se ai ofertues i ka dhënë informacione përmbajtjeish të gabuara ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
- 2 Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
- 3 Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
 - Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
 - Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
 - Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuar në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar deri ne shumën e sigurimit, siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Shuma e Sigurimit €: 25,000.00

Ky sigurimi vlen deri: 08/02/2020

Nënshkrimi dhe Vula e Garantusit

Data e lëshimit: 10/10/2019





Sigurimi i Tenderit

Nr Policës
Policy No:

1008757

Kontraktuesi:	KS"BESA SECURITY"SHPK		
Përfaqësuar nga:	GRANIT HASANI		
Adresa:	PRISHTINE		
Nr. i Biznesit:	70191421		
Garantuesi:	K.S. Kosova e Re SH.A		
Banka e Garantuesit:	BEK - Banka Ekonomike		
Përfituesi:	KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES		
Adresa e Përfituesit:	PRISHTINE		
Shuma e Sigurimit:	25,000.00		
Numri i Përkrahimit:	616-19-3238-211		
Titulli i Kontratës:	Sigurimi i objekteve te Komunes se Prishtines		
Data e Fillimit:	10/11/2019	Data e Mbarimit:	08/02/2020
Primi:	118.64 TVSH.	21.36	Totali: 140.00
Mënyra e Përcaktimit:	Transfer Bankar	Nr	1401000000597893
Data e Lëshimit:	10/10/2019 00:00:00		

Lënda e garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

1. Mbështetur në këtë Policë - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merr përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë policë.

2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.

3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit / Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet te Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi te Siguruesi / Garantuesi).

4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.

5. Për policën e sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (te Siguruarit) si dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng).

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit pajtohem që K.S. Kosova e Re të ruaj të dhënat e mia personale/biznesit, të cilat do të përdoren nga kompania për qëllime statistikore, hulumtime dhe raportime në Regjistrin Kreditar të Kosovës, si dhe për trajtimin e demeve. Gjithsesi kuptohet se unë i siguroari me vullnet të lire, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit dhe kame lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit të

Erand Pajaziti, B.J. Broker
Zyrtari i Shitjes



I Siguruarit